



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS**  
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2024:130680  
Datë: 06.06.2024  
Numri i dokumentit: 05788775

**C - III. – 24 – 0063**

**Paditësit - propozuesi i sigurimit:**

R I H O I H, Sh I H, G I H, B H H, dhe G H H, K H H, E E H, N Sh H, R Z H, A N H, J Z H, dhe F M H që të gjithë nga fshati Ke E i Komunës në Drenasit etj e të cilët me autorizime të veçanta i përfaqëson, av. K B Th nga Prishtina .

**Kundër:**

**Të paditurat-kundërshtaret e sigurimit:**

**I.** Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) me seli në Prishtinë, Rr. “Dritan Hoxha” nr. 55, Lagja, ”Lakrishtë”, Prishtinë

**II.** Ndërmarrja Shoqërore (NSh), ”Drenica” me seli në Drenas (në likuidim).

**Objekti i çështjes :** Vërtetimi i bashkëpronësisë e me propozimin për caktimin e masës së sigurimit.

**Për :** Palët ndërgjyqëse.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës (DhPGJSK), për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP, me Kolegjin në përbërje nga gjykatësi, Agron Hoxhaj, gjykatës kryesues, gjykatësen, Diellza Hoxha, dhe gjykatësen, Hajrie Shala, anëtarë të kolegjit, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur me **dt.06.06.2024**, dhe në mënyrë unanime mori, këtë:

## AKTVENDIM

**I.** Propozimi i paditësve – propozuesve të sigurimit, R I H nga fshati Ke E i Komunës në Drenasit etj e me të cilin kanë kërkuar që të :’’ Caktohet masa e sigurisë e me të cilën i ndalohet të paditurës, Agjencisë Kosovare të Privatizimit që në paluajtshmërinë në sipërfaqe prej 28, ha e cila shtrihet në dy Zona kadastrale dhe atë pjesa e parcelës me numr të ngastrës kadastral ..., shtrihet në ZK K e P ndërsa pjesa e parcelës me numër të ngastrës kadastrale ..., shtrihet në ZK Z i U, që të ndërmarrë ndonjë veprim me qëllim ndryshimi të gjendjes ekzistuese faktike në pjesën e paluajtshmërisë, shitja, lëshimi me qira, bartja në personat e tretë, ngarkimi me ndonjë të drejtë sendore ose detyrimore apo ndryshimi i gjendjes faktike të paluajtshmërisë dhe t’i NDALOHET, të paditurës dhe personave të tretë të shfrytëzojnë këtë patundëshmëri të regjistruar në emër të saj pa bazë ligjore ....”, **REFUZOHET si i pabazuar.**

**II.** Nuk caktohen taksa tjera gjyqësore në këtë çështje juridike kontestimore.

### **Rrethanat faktike dhe procedurale**

Me dt.03.05.2024, paditësit – propozuesit e sigurimit, kanë paraqitur padinë për vërtetimin e të drejtës së pronës dhe propozimin për caktimin e masës së sigurisë dhe se në këtë padi, në mes tjerash kanë theksuar se ata janë trashëgimtarë të E Z H nga fshati K e E, se tani i ndjeri E Z H, në vitin 1928, e kishte blerë paluajtshmërisë nga shitësi, A H nga Vushtrria dhe atë në sipërfaqe prej 38 hektarësh, tokë e cila gjendet në dy Zona Kadastrale dhe atë pjesa e parcelës me numr të ngastrës kadastrale, nr..., shtrihet në ZK K e P ndërsa pjesa e parcelës me numër të ngastrës kadastrale nr., shtrihet në ZK Z i U, e duke i pasur parasysh sfidat që kanë ekzistuar në periudhën kur është blerë kjo paluajtshmëri, e dëshira për të transformuar pronësinë nga sistemi i saja kohe i cili ishte i barazuar me një koncept të mangët të quajtur, ’’pronë shoqërore’’ dhe kalimin e asaj prone në ’’pronë private’’ deri më tani paditësit, kanë hasur mjaft probleme, se paraardhësi i paditësve, ka qenë pronar i kësaj paluajtshmërie, dhe pas pagesës së çmimit ka hyrë shfrytëzim dhe posedim të kësaj prone të cilën e ka shfrytëzuar për disa vite me radhë, e duke referuar në provën e dëgjimit të palëve dhe certifikatën e vdekjes së E H si dhe e ka përshkruar historikun procedural rreth pronës në fjalë e më gjerësisht si në këtë padi si dhe bashkarisht me me këtë padi i kanë propozuar gjykatës që të merr aktvendim e me të cilin, caktohet masa e sigurisë e me të cilën i ndalohet të paditurës, Agjencisë Kosovare të Privatizimit që në paluajtshmërinë në sipërfaqe prej 28, ha cila shtrihet në dy Zona Kadastrale dhe atë pjesa e parcelës me numr të ngastrës kadastral ..., shtrihet në ZK K e P ndërsa pjesa e parcelës me numër të ngastrës kadastrale ..., shtrihet në ZK Z i U, që të ndërmarrë ndonjë veprim me qëllim ndryshimi të gjendjes ekzistuese faktike në pjesën e paluajtshmërisë, shitja, lëshimi me qira, bartja në personat e tretë, ngarkimi me ndonjë të drejtë sendore ose detyrimore apo ndryshimi i gjendjes faktike të paluajtshmërisë dhe t’i NDALOHET, të paditurës dhe personave të tretë të shfrytëzojnë kë të patundëshmëri të regjistruar në emër të saj pa bazë ligjore, se regjistrimi i kësaj patundëshmërie në emër të të paditurës, paditësve është duke iu shkaktuar dëm të kobsiderueshëm andaj me prova të mjaftueshme e kanë bërë të besueshme propozimin për

caktimin e masës së sigurisë që e paditura këtë pronë e ka regjistruar pa bazë ligjore në librat kadastralë në emër të saj, si dhe nga kjo bazë, paditësve, iu kanë shkelur të drejtat në pronë nga e paditura sepse një gjë e tillë është në kundërshtim me të drejtën e pronës e cila është e garantuar edhe Kushtetutën e Republikës së Kosovës, neni 46, Mbrojtja e pronës në par.3 : "Askush nuk mund të privohet në mënyrë arbitrare nga prona ..." e më gjerësisht si në këtë propozim për caktimin e masës së sigurimit.

Paditësit, kësaj padie ia kanë bashkangjitur, provat siç janë: Regjistrin e pronave nga ZK K e E e që pretendojnë se kanë pronë në pronat shoqërore, në Zonat Kadastrale, K e P dhe Z i U e me emrat e paditësve, G I H, Sh I H, O I H dhe R I H B H H, dhe G H H, K H H, E E H, R Z H, N Sh H, J Z H, A N H dhe F M H si dhe Skicën e matjeve, certifikatën e vdekjes, V .. të dt...të Zyrës së Gjendjes Civile, Komuna e Gllogovcit së E H, autorizimet e noterizuara të të gjithë paditësve të dhëna për av. K B Th nga Prishtina për t'i përfaqësuar në këtë çështje juridike kontestimore, si dhe Procesverbalin të shqyrtimit kryesor në lëndën, C.447/58 e përpiluar me dt.16 III.1959 në Gjykatën e Rrethit Prishtinë në gjuhën serbe dhe shqipe (të përkthyer).

Me dt.21.05.2024, e paditura, AKP-ja me seli në Prishtinë, duke vepruar sipas Urdhrit të kësaj gjykate, C – III – 24 – 0063 të dt.10.05.2024 për të paraqitur përgjigje në propozimin e paditësit – propozuesit të sigurimit për caktimin e masës së përkohshme të sigurimit e duke theksuar se në tërësi e kundërshton një propozim të tillë një propozim për caktimin e masës së sigurisë si të pa drejtë dhe të pa bazuar në ligj, e duke theksuar se asnjëri nga kushtet ligjore për marrjen e masës së përkohshme sipas nenit 61 të Ligjit, Nr.06/L- 086, nuk është plotësuar, se paditësit, nuk e kanë dëshmuar përpara gjykatës se a kanë bërë të besueshme kërkesën për kompensim dëmi në padi për dëmin e shkaktuar nga ana e kundërpapozuesit, se pretendimi pronësor i pranueshëm *prima facie (funus boni iuris)*, është një element i domosdoshëm i pranuar si kusht *sine qua non* nga gjykata në praktinë e saj për pranimin e kërkesës për lëshimin e Urdhrit për masë të përkohshme e në këtë kuadër, parashtruesit, këtu propozuesit e sigurimit, është dashur, që t'a provojnë se pretendimi i tyre pronësor qëndron në masën që ata kanë gjasa të dukshme që t'a fitojnë kontestin në gjykatë, prej këtu në fakt, nuk ka më çështje të kontestueshme e lerë më "të drejtë subjektive të propozuesve në dukje" pasi neni 5, par.1.2 i Ligjit, Nr.04/L – 034 për AKP-në, nuk lë ekuivoke për përcaktimin se : " Agjencia ka kompetenca ekskluzive që të administroj: 1.1.ndërmarrjet në pronësi shoqërore, pavarësisht nëse i janë nënshtruar transformimit apo jo; 1.2.të gjitha asetet që ndodhen në territorin e Kosovës, pavarësisht a janë të organizuara si subjekte apo jo, të cilat kanë qenë pronë në pronësi shoqërore me ose pas 22 Marsit 1989 ... ". Tutje ka shtuar edhe mos keqzotueshmëri e pasojave të pa ndreqshme/ dëmit të riparueshëm, e duke thënë se AL-ja, thekson se propozuesit e sigurimit as nuk e kanë vërtetuar dhe as që nuk janë thirrur asnjëherë se AKP-ja, iu ka shkaktuar dëme të menjëhershme dhe të pa riparueshme, se neni 661 i Ligjit, Nr.06/L-086 për DhPGJSK–në, përcakton se : " Pas parashtrimit të propozimit nga njëra palë, Dhoma e Posaçme mund të caktojë një masë të sigurimit me kusht që parashtruesi jep prova të besueshme për ekzistimin e kërkesës apo të së drejtës subjektive të tij dhe se do të ketë dëme të menjëhershme dhe të riparueshme për palën nëse nuk miratohet masa e sigurimit. Dëmi konsiderohet si i "pariparueshëm" vetëm nëse nuk mund të zhdëmtohet në mënyrë të arsyeshme me anë të një kompensimi financiar. Propozimi për caktimin e masës së sigurimit duhet dorëzuar së bashku me kërkesën, ose nëse dorëzohet pas parashtrimit të një kërkesë/padie, atëherë ajo duhet t'i referohet asaj kërkesë/ padie", se

bazuar në këtë nen për t'u caktuar masa e sigurimit në bazë të kërkesës së propozuesit duhet të përmbushen dy elementet në mënyrë kumulative sikur që janë : - ekzistimi i kërkesë apo i së drejtës subkative të tij; dhe shkaktimi i dëmit të menjëhershëm dhe të pa riparueshëm, kështu që AL-ja, thekson se për parashtruesit nuk janë përmbushur në mënyrë kumulative të dy kushtet ashtu siç e ka përcaktuar neni i lartë cekur dhe i ka propozuar gjykatës që në pajtim me arsyetimin dhe dispozitat ligjore të cekura me lartë, kërkon që të refuzoj si të pa pabazuar propozimin e paditësve – propozuesve të sigurimit për caktimin e masës së sigurimit e më gjerësisht si në petitudin e kësaj Përgjigjeje në propozimin e paditësve – propozuesve të sigurimit për caktimin e masës së sigurimit.

Me dt.23.05.2024, kjo gjykatë, me Urdhrin e saj, C - III. – 24 – 0063 të dt.23.05.2024, Përgjigjen e të paditurës – kundërshtarës së sigurimit, AKP-së me seli në Prishtinë të bërë në propozimin e paditësve – propozuesve të sigurimit për caktimin e masës së sigurimit, ia ka dërguar paditësve – propozuesve të sigurimit dhe të cilin Urdhër, e autorizuar e paditësve e ka pranuar me dt.30.05.2024 por se deri më tani, nuk është deklaruar lidhur me këtë Përgjigje të të paditurës – kundërshtares së sigurimit, AKP-së me seli në Prishtinë.

Për detaje të tjera referimi mund të bëhet në dosjen e lëndës.

### **Arsyetimi ligjor**

Ne bazë të nenit 2 par.4 dhe nenit 77 par.1 pika 1.1 të Ligjit Nr.06/L-086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (DhPGjSK) për Çështjet që Lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP), gjykata zbaton dispozitat procedurale të këtij ligji.

Procedura gjyqësore pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet në Lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në vazhdim: Dhoma e Posaçme), është e rregulluar Ligjin nr.06/L-086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet në Lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, si ligj i veçantë.

Në bazë të nenit 61 par.2 të Ligjit për Dhomën e Posaçme, gjykata vlerëson se faktet dhe provat që i përmban propozimi për caktimin e masës së përkohshme, nuk e vërtetojnë propozimin për caktimin e masës së sigurimit dhe se gjykata merr aktvendim, pa caktuar seancës dëgjimore.

Pas shqyrtimit të propozimit të paditësve – propozuesve të sigurimit për caktimin e masës së sigurimit si dhe pretendimeve të të paditurës të dhëna në përgjigjen e saj në propozimin për caktimin e masës së përkohshme të sigurimit, gjykata ka vlerësuar dhe ardhur në përfundimin se propozimi i paditësve – propozuesve të sigurimit për caktimin e masës së sigurimit, është i pabazuar.

Sipas nenit 61 të Ligjit nr. 06/L-086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (DhPGjSK), parashihet se :'' *Pas parashtrimit të propozimit nga njëra palë, Dhoma e Posaçme mund të caktojë një masë të sigurimit me kusht që parashtruesi jep prova të besueshme për ekzistimin e kërkesës apo të së drejtës subjektive të tij dhe se do të ketë dëme të menjëhershme dhe të riparueshme për palën nëse nuk miratohet masa e sigurimit. Dëmi*

*konsiderohet si i "pariparueshëm" vetëm nëse nuk mund të zhdëmtohet në mënyrë të arsyeshme me anë të një kompensimi financiar. Propozimi për caktimin e masës së sigurimit duhet dorëzuar së bashku me kërkesën, ose nëse dorëzohet pas parashtrimit të një kërkesë/padie, atëherë ajo duhet t'i referohet asaj kërkesë/ padie ... Dhoma e Posaçme mund të nxjerrë një vendim lidhur me propozimin për caktimin e masës së sigurimit pa mbajtjen e seancës dëgjimore dhe pasi që pala tjetër të ketë pasur mundësinë për të paraqitur argumentet kundërshtuese me shkrim''.* Në rastin konkret, Dhoma e Posaçme, palëve ndërgjyqëse, ua ka dhënë mundësinë si palë, që t'i parashtrajnë qëndrimet e tyre në njërën anë paditësve – propozuesve të sigurimit e në anë tjetër të paditurës – kundërshtares së sigurimit për të paraqitur argumentet kundërshtuese me shkrim, dhe se paditësit – propozuesit e sigurimit, kanë ngelur pranë propozimit për caktimin e masës së sigurimit derisa e paditura – kundërshtarja e sigurimit, e ka kundërshtuar një propozim të tillë derisa Dhoma e Posaçme mund të nxjerr një masë të sigurisë me kusht që parashtruesi jep prova të besueshme se do të ketë dëme të menjëhershme dhe të pariparueshme për palën nëse nuk miratohet masa e sigurimit. Dëmi konsiderohet si i "pariparueshëm" vetëm nëse nuk mund të zhdëmtohet në mënyrë të arsyeshme me anë të një kompensimi financiar.

Kolegji i kësaj gjykate, vlerëson se në rastin konkret për caktimin e masës së sigurimit, janë të nevojshme të plotësohen dy kushte ligjore në mënyrë kumulative dhe atë :

- Propozuesit e masës së sigurimit, duhet të japin prova të besueshme për ekzistimin e kërkesës apo të drejtës subjektive të tyre dhe
- Propozuesit duhet të japin prova, që pa caktimin e masës së sigurimit do të kenë dëme të menjëhershme dhe të pa riparueshme, e që sipas kësaj dispozite dëmi i pa riparueshëm është vetëm nëse nuk mund të zhdëmtohet në mënyrë të arsyeshme me anë të një kompensimi financiar.

Palët si në rastin konkret, duhet të ofrojnë prova të besueshme për të provuar ekzistimin e të drejtës së tyre subjektive dhe se barra e provave bie mbi paditësit – propozuesit e sigurimit, dhe se paditësit – propozuesit e sigurimit, propozimit të tyre për caktimin e masës së përkohshme të sigurimit, nuk ia ka bashkangjitur certifikatën për të dhënat e patundshmërisë në sipërfaqe prej 28, ha e cila shtrihet në dy Zona kadastrale dhe atë pjesa e parcelës me numr të ngastrës kadastral ..., shtrihet në ZK K e P ndërsa pjesa e parcelës me numër të ngastrës kadastrale ..., shtrihet në ZK Z i U por vetëm regjistrimin e pronarëve që prtendojnë se lanë pronë në pronat shoqërorer, në Zonat Kadastrale, ZK K e P dhe Z i U, si dhe skicën gjegjëse për këto prona por pa pasur evidencë kadastrale se në emër të kujt evidentohen pronat gjegjëse në emër të NSH-së në fjalë apo në emër të dikujt tjetër, por nuk ia ka bashkangjitur asnjë provë tjetër e me të cilat do t'a bënte të besueshme caktimin e masës së sigurimit, andaj, pa paragjykim të vendosjes së plotë nga ana e gjykatës lidhur me çështjen kryesore sipas padisë së paditësve – vërtetimi i bashkëpronësisë, Kolegji i kësaj gjykate, gjykata konstaton se në këtë rast, paditësit – propozuesit e sigurimit, nuk kanë ofruar dëshmi të besueshme, që do të arsyetonin lëshimin e masës së sigurimit sepse të njëjtët, në arsyetimin e këtij propozimi, bazohen në atë se e paditura – kundërshtarja e sigurimit, paluajtshmërinë e cila është objekt i kësaj padie, e ka regjistruar në emrin e saj e pasur parasysh historiatin e kësaj prone, pa e njoftuar paditësit e

në këtë mënyrë ua kanë cenuar të drejtën në pronë e prona private është e garantuar edhe me nenin 46 par.1 të Kushtetutës e nga kjo rrjedh se paditësit janë pronarë të kësaj prone që nga viti 1910 dhe të njëjtë në përjashtim të periudhën kur janë vendosur kolonistët malazez, e kanë shfrytëzuar pa asnjë pengesë. Mirëpo paditësit – propozuesi i sigurimit, propozimit për caktimin e masës së sigurimit, nuk ia kanë bashkangjitur asnjë provë të vetme në funksion të të provuarit të ekzistimit të së drejtës së tyre subjektive, pra paditësit/ propozuesit e sigurimit, nuk e ka bërë të besueshme ekzistimin e kërkesës apo të drejtës së tyre subjektive, me vetë faktin se paditësi thirret se janë pronar përmes paraardhësit të tyre, E Z H nga fshati Ke E por se me gjendjen e tillë të provave të bashkangjitur propozimit të tyre për caktimin e masës së sigurimit, nuk ka bazë të arsyeshme për lëshimin e një masë të sigurimit.

Palët po ashtu edhe duhet të ofrojnë prova të besueshme se do të rezultojë me dëmtim të menjëhershëm dhe të pa riparueshëm financiarisht nëse nuk miratohet propozimi i tyre për caktimin e masës së sigurimit e këto kriteret janë përcaktuar në atë mënyrë që nëse ndonjëra nga të mësipërmet mungon, kërkesa do të refuzohet, dhe se Kolegji i kësaj gjykate, vlerëson se as kushti i dytë për caktimin e masës së sigurimit, nuk është përmbushur, që ka të bëjë me dëmin e menjëhershëm dhe të pa riparueshëm, i cili dëm nuk mund të kompensohet, pasi që në supozim të pësimi të ndonjë dëmi, dëmi do të mundë të kompensohet nga e paditura – kundërshtarja e sigurimit, AKP-ja, nëse bëhet i provueshëm dhe mbështetet në ndonjë bazë juridike. Andaj, Kolegji i kësaj gjykate me gjendjen e tillë të shkresave të lëndës, ka vlerësuar se paditësit – propozuesit e sigurimit tani për tani nuk e kanë bërë të besueshme ekzistimin e të drejtës së tyre subjektive si dhe nuk kanë ofruar prova të besueshme se do të rezultojë me dëmtim të menjëhershëm dhe të pa riparueshëm financiarisht nëse nuk miratohet propozimi i tyre për caktimin e masës së sigurimit. Pra duke qenë se me provat e bashkangjitura propozimit të tyre për caktimin e masës së sigurimit nga paditësit – propozuesi i sigurimit, këtë propozim të tyre e bëjnë të pa bazuar, andaj si rezultat i këtij qëndrimi del përfundimi se propozimi i paditësit – propozuesit sigurimit për lëshimin e masës së sigurimit për patundshmëritë respektive, nuk i plotëson kriteret ligjore ashtu siç parashihen sipas nenit 61 par.1 të Ligjit për DhPGJSK-së, për këtë arsye Kolegji i kësaj gjykate, propozimin e paditësve – propozuesve të sigurimit për caktimin e masës së sigurimit, e refuzoj si të pabazuar.

### **Shpenzimet procedurale:**

Paditësit – propozuesit e sigurimit, kanë paguar taksën gjyqësore për propozimin e tyre për caktimin e masës së sigurimit dhe atë në shumën prej 100.00 € dhe se për këtë arsye, gjykata nuk caktoj taksa tjera gjyqësore në këtë çështje juridike kontestimore lidhur me propozimin për masën e sigurimit.

Prandaj nga ajo që u tha më lartë, kjo gjykatë vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi e në bazë të nenit 4 par.9, 9 dhe nenit 61 par.1 të Ligjit Nr.06L/086 të Dhomes së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (DhPGjSK).

**DHOMA E POSAÇME E GJYKATËS SUPREME TË KOSOVËS**

**2024:130680, 06.06.2024**

Kolegji i Shkallës së I-rë

Agron Hoxhaj, Gjykatës kryesues \_\_\_\_\_

Diellza Hoxha, Gjykatëse \_\_\_\_\_

Hajrie Shala, Gjykatëse \_\_\_\_\_

**KËSHILLË JURIDIKE:**

Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim për Kolegjin e Apelit të DhPGjSK-së dhe atë në afatin prej **15 (pesë mbëdhjetë) ditëve** pas ditës së pranimit të këtij aktvendimi e në bazë të nenit 9 par.6 të Ligjit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (DhPGjSK).